



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenin 11, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimit, 01-Nr-105, të datës 26.05.2003, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për emërimin e komisionit

Neni 1

Emërohet komisioni për pranimin dhe nominimin e propozimeve që vijnë nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave për dhënien e shpërblimeve **“Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjes “13 Qershori”** me këtë përbërje:

- 1.1. -----kryesues/e
- 1.2. -----anëtar/e
- 1.3. -----anëtar/e
- 1.4. -----anëtar/e
- 1.5. -----anëtar/e
- 1.6. -----anëtar/e
- 1.7. -----anëtar/e

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga qytetarët, institucionet, shoqatat, kryesitë e fshatrave, prej individëve, etj, bazuar në vendimet e Kuvendit të Komunës për ndarjen e shpërblimit **“Emblema e artë”, shpërblimit “Skënderbeu” dhe mirënjohjes, “13 Qershori”** të datës 26.05.2003 dhe pas kryerjes së detyrës propozimet i dorëzojnë tek Kuvendi i Komunës për miratim.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e konform Shkresës së Ministrisë së Financave, Punën dhe Transfereve, Nr. 386-1/2022 të datës 23.03.2022, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi, 01-Nr-016-12176, i datës 28.02.2022, për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën të Komunës së Suharekës.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr-10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenin 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimit, 01-Nr-016-12153 i datës 28.02.2022 i komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet në pronësi të Komunës nga **Bashkim Sali HOXHAI** dhe z. **Sami Dervish ELSHANI**.

Neni 2

Pika 1.3, e Nenit 1, të vendimit bazike ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

-----Përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës, emërohet anëtare e komisionit të lartcekur, pasi që **Festë KABASHI** ka dhënë dorëheqje.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera komple të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-12153, të datës 28.02.2022, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF
SUHAREKA

11/06/2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		
KRYETARI I KOMUNËS - PRILJENJE		
Nënda Org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix
01	016	33340 Z

11 Nr.	Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës	Datë: 11.06.2021
--------	--	------------------

Për:	Kryetarin e Komunës z.Bali MUHARREMAJ
Nga:	Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale.
Lënda:	Vlerësimi dhe Rekomandimi për Konkurrimin e Hapur Nr. 01/2021 , i shpallur me datë 20.04.2021

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-13801 të datës 26.02.2021 të Asamblesë Komunale, në bazë të procesverbalit NR.55/2021 pika 2 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluejtshme të komunës të datës 11.06.2021, në bazë të Vendimit 01-Nr-016-33073 të datës 10.06.2021 të Komisionit të ankesave, njoftimit publik 01-Nr-016-29589 të datës 27.05.2021, LIGJI NR.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës, në bazë të Rregullorja (QRK) –Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës, Vendimit për formimin e komisionit 01-Nr-016-41940 të datës 28.06.2019, **komisionit përkatës paraqet këtë:**

RAPORT :

Me datë 20.04.2021 është mbajtur takimi me anëtarët e komisionit për përcaktimin e kushteve për aplikim dhe kriterëve për vlerësim, ku është publikuar ftesa për :

- **KONKURIM TË HAPUR Nr. 01/2021**, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës komunale për :
1. **Parcelat kadastrale:**
- **Nr.2785/76** me sipërfaqe prej 4481m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.
- **Nr.2785/77** me sipërfaqe prej 5000m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.
- **Nr.2785/81** me sipërfaqe prej 4500m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.
- **Nr.2785/82** me sipërfaqe prej 4490m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.
- **Nr.2785/83** me sipërfaqe prej 2747m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.
- **Nr.2785/84** me sipërfaqe prej 3990m², sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore”, pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Në bazë të afateve ligjore të përcaktuara me Ligjin Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluejtshme të Komunës (**Ligji Nr. 06/L-092**), komisioni ka caktuar afatin për tërheqjen e formularit të ofertave deri me datën 04.05.2021 deri në ora 12:00, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë. Afati për dorëzimin e ofertave me datën 04.05.2021 deri në ora 15:00 zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë..

Hapjen e ofertave datën 07.05.2021 në ora 13:30 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Në bazë të listës së prezantuar nga zyra pritëse e administratës te gjendja civile , formularët për aplikim i kanë tërhequr gjithsej 5 (pesë) ofertues, dhe deri në afatin e dhënë në Konkursim të Hapur janë dorëzuar gjithsej 4 (katër) oferta me numër protokolli :

01-Nr-016-25431 datë 05.05.2021 “BLETA “ SH.P.K.- Artan Ramshaj.

01-Nr-016-25459 datë 05.05.2021 “BURIMI-AG”-Avni Gashi.

01-Nr-016-25533 datë 05.05.2021 “ENERGIE SH.P.K” – Samir Berisha.

01-Nr-016-25536 datë 05.05.2021 “EUROING SHPK” –Mefail Gashi.

Në bazë të kontrollimit dhe vlerësimit të dokumenteve në këtë konkursim të hapur **kanë aplikuar gjithsej 4 (katër) ofertues , ku:**

01-Nr-016-25431 datë 05.05.2021 “BLETA “ SH.P.K.- Artan Ramshaj.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara konstatojmë se : “BLETA “ SH.P.K. me përfaqësues Artan Ramshaj ka aplikuar për dy parcela kadastrale:

Nr.2785/76 me sipërfaqe prej 4481m²

Nr.2785/77 me sipërfaqe prej 5000m²

“sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet” , pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Komisioni i ka kontrolluar dhe kemi konstatuar që janë në rregull.

Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja për 2 (dy) vitet e fundit- 11141746.70 €

Vlera e investimeve – 2,183,44.50 €

Çmimi i ofruar për m²:0.05 € m² në vitë.

Numri i punëtorve - 80

Nuk posedon prone në shfrytëzim në ZI-Shirokë.

Plani dinamik është brenda kornizës kohore të caktuar - 24 muaj.

Projekti ideor - Po

01-Nr-016-25459 datë 05.05.2021 “BURIMI-AG”-Avni Gashi.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara konstatojmë se “BURIMI-AG”- me përfaqësues Avni Gashi ka aplikuar për katër parcela kadastrale:

Nr.2785/81 me sipërfaqe prej 4500m²

Nr.2785/82 me sipërfaqe prej 4490m

Nr.2785/83 me sipërfaqe prej 2747m

Nr.2785/84 me sipërfaqe prej 3990m²

“ sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore ” , pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Operatori ekonomik “BURIMI-AG”- me përfaqësues Avni Gashi nuk i ka përmbush kriteret sipas thirrjes së konkursimit të hapur nr.01/2021. Projekti ideor nuk është sipas kushteve të planit rregullativ të hollësishëm në ZI Shirokë – dhe sipas normave teknike .

Deklarata vjetore nuk është në harmoni me vlerën e investimeve.

Andaj komisioni njëzëri vendosi të diskualifikoi nga konkursimi .

01-Nr-016-25533 datë 05.05.2021 “ENERGIE SH.P.K” – Samir Berisha.

Gjatë shqyrëtimit të dokumenteve të dorëzuara konstatohet se “ENERGIE SH.P.K me përfaqësues Samir Berisha ka aplikuar për katër parcela kadastrale:

Nr.2785/81 me sipërfaqe prej 4500m²

Nr.2785/82 me sipërfaqe prej 4490m

Nr.2785/83 me sipërfaqe prej 2747m

Nr.2785/84 me sipërfaqe prej 3990m²

“ sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore ” , pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Operatori ekonomik “ENERGIE SH.P.K” me përfaqësues Samir Berisha nuk i ka përmbush kriteret sipas thirrjes së konkurimit të hapur nr.01/2021.

Deklarata vjetore nuk është në harmoni me vlerën e investimeve . Vlera e investimeve e deklaruar në formular nuk përputhet me paramasa dhe paralogari sipas kriterëve të thirrjes.

Mungon plani investiv.

Gabime aritmetike të paramasës dhe paralogarisë sipas kriterëve të thirrjes.

Andaj komisioni njëzëri vendosi të diskualifikoi nga konkurimi .

01-Nr-016-25536 datë 05.05.2021 “EUROING SHPK” –Mefail Gashi.

Gjatë shqyrëtimit të dokumenteve të dorëzuara konstatohet se “EUROING SHPK me përfaqësues Mefail Gashi ka aplikuar për katër parcela kadastrale:

Nr.2785/81 me sipërfaqe prej 4500m²

Nr.2785/82 me sipërfaqe prej 4490m

Nr.2785/83 me sipërfaqe prej 2747m

Nr.2785/84 me sipërfaqe prej 3990m²

“ sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore ” , pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

Operatori ekonomik “EUROING SHPK me përfaqësues Mefail Gashi nuk i ka përmbush kriteret sipas thirrjes së konkurimit të hapur nr.01/2021.

Deklarata vjetore nuk është në harmoni me vlerën e investimeve . Vlera e investimeve e deklaruar në formular nuk përputhet me paramasa dhe paralogari sipas kriterëve të thirrjes.

Mungon plani investiv.

Gabime aritmetike të paramasës dhe paralogarisë sipas kriterëve të thirrjes.

Andaj komisioni njëzëri vendosi të diskualifikoi nga konkurimi .

Ndaj këtij procesi Operatori Ekonomik “BURIMI-AG”- me përfaqësues Avni Gashi ka parashtruar ankesë me numër 01-Nr-615-31355 datë 03.06.2021, kundër njoftimit publik 01-Nr-016-29589 të datës 27.05.2021 të komisionit për zhvillimin e procedurave dhe vlersimit të ofertave.

Komisioni i ankesave në seancën e mbajtur me datë 10.06.2021 njëzëri miratohet kështu:

VENDIM.

1. Refuzohet ankesa e ankuesit Burimi- Ag 01-Nr-615-31355 datë 03.06.2021.
2. Mbetet në fuqi njoftimi publik 01-Nr-016-29589 të datës 27.05.2021

Rekomandim

Në bazë të vlerësimit të lartëcekur, komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, rekomandon si fitues :

Për parcelën

Nr.2785/76 me sipërfaqe prej 4481m²

Nr.2785/77 me sipërfaqe prej 5000m²,

“sipas planit rregullativ “Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet” , pasuri shoqërore në emër të “Komuna e Suharekës”.

1. “BLETA “ SH.P.K. me përfaqësues Artan Ramshaj 1175336105

Konkludim :

I nderuar Kryetar i Komunës z.Bali Muharremaj dhe kryesues i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,

Kërkojmë nga ana juaj që të shqyrtoni punën e komisionit vlerësues dhe të merret vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në afat prej 99 (nëntëdhjet e nëntë) vjet për parcelat kadastrale të lartëcekura.

Kryesuesi i Komisionit
Emrush BYTYÇI





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, e në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe konform nenit 6, të Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Suharekës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M
Për themelimin e komisionit

Neni 1

- 1.1 Themelohet komisioni për të udhëhequr dhe koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale në tërë territorin e Komunës së Suharekës.
- 1.2 Komisioni do të përbehet prej 7, (shtatë) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:
 - 1.2.1 -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.2 -----përfaqësuese/e nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.3 -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.4 -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.5 -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
 - 1.2.6 -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
 - 1.2.7 -----përfaqësues/e nga secili fshat, vendbanim apo lagje ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.

Neni 2

- 2.1 Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokal në fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunës e Suharekës, konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Suharekës,
- 2.2 Komisioni pas përfundimit të të gjitha proceduarve për zgjedhjen e këshillave lokal ka për obligim që të raporton para Kuvendit të Komunës së Suharekës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 3

3.1 Mandati i anëtareve të Komisionit të është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim personit fizik dhe juridik të cekur më poshtë; I jepet në shfrytëzim afatgjatë deri **99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite, prona e paluajtshme, pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, në **“Zonën industriale”** në Shirokë, **për ushtrim të veprimtarisë afariste**, sipas rekomandimit 01-Nr-016-33340 të datës 11.06.2021, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.**

1.1 Firmës “Bleta” SH.P.K me seli në Rr. “Xhavit Sylaj” në Suharekë të cilën e përfaqëson Artan (Musli) RAMSHAJ, nga fshati Peqan i jepet; parcela Nr-2785/76, me sipërfaqe të përgjithshëm S=4481m² dhe parcela Nr-2785/77, me sipërfaqe të përgjithshëm S=5000m² me destinim sipas planit rregullativ **“Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet”.**

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **00.04.2022** dhe përfundon afati më datën, **00.04.2121**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

3.1 Obligohet; Kryetari i Komunës që me **personat fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të Komunës**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. Obligohen; përfituesit e pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personat fizikë dhe juridikë të cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancionin bankar ose sigurimin nga kompanitë e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 4

4.1 **Obligohen** shfrytëzuesit e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI